



**AUTO CLUB
ALBANIA**

Automobile Club Albania
Rr. "Ismail Qemali" No. 32/1 Tirane 1019
Shqiperi
T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,
E: info@aca.al / W: www.aca.al

Datë: 21/06/2021

Nr. 25 Prot.

Drejtuar: Znj. Ogerta MANASTIRLIU
Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për dijeni: Znj. Yllka KUKALI
Drejtoreshë e Spitalit Rajonal Krujë

Z.Arben ZENELAJ
Drejtore i Spitalit Universitar të Traumës

Subjekti: Kërkesë për mbështetje për organizmin e garës sportive ndërkombëtare me autovetura "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021"

Të nderuar,

Klubi i Automobilit të Shqipërisë (ACA), me autoritetin e Federatës Shqiptare të Sporteve të Automobilizimit (FASA), do të organizojë në datat 11 Shtator - 12 Shtator 2021, aktivitetin e garës sportive ndërkombëtare të shpejtësisë me autovetura, "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021". Ky është viti i 8-të që kjo garë ndërkombëtare zhvillohet në territorin e Bashkisë Krujë.

"Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021" është garë sportive me autovetura e regjistruar zyrtarisht në Kalendarin Kombëtar Sportiv të FASA e cila ka të drejtën e organizimit të saj.

Kjo garë është gjithashtu e regjistruar dhe është e vlefshme për kampionatin e Federatës Ndërkombëtare të Automobilizimit (FIA www.fia.com) për Zonën e Europës Qëndrore (CEZ-FIA <http://www.cez-motorsport.com/2021/cez-hill-climb/>). Në garë do të marrin pjesë mbi 30 garues nga Shqipëria, Italia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Polonia, Sllovenia, Kroacia, etj. Klubi ACA dhe Federata FASA, për 7 vjet, organizojnë garën sportive ndërkombëtare në territorin e Bashkisë Krujë në Rrugën e Malit, në segmentin rrugor Mali i Krujës - Sarisalltik.

Aktiviteti sportiv automobilistik do të zhvillohet në dy ditë:

- datë 11 Shtator 2021, ditën e shtunë, ora 08:30 deri në orën 14:00, do të zhvillohet sesioni i provave zyrtare;
- datë 12 Shtator 2021, ditën e dielë, nga ora 09:00 deri në orën 15:00 do të zhvillohet sesioni i garave.

Për sa më sipër, me anë të kësaj shkrese kërkojmë mbështetjen Tuaj dhe të institucionit që Ju drejtoni në organizimin e këtij eventi, sipas të gjithë procedurave përkatëse. Kërkojmë mbështetjen Tuaj për të na vendosur në dispozicion burimet spitalore dhe të urgjencës në rast të ndonjë aksidenti të mundshëm gjatë zhvillimit të garës. Paraprkisht, po Ju konfirmojmë se i jemi drejtuar për mbështetje dhe kemi vënë në

MEMBER OF





**AUTO CLUB
ALBANIA**

Automobile Club Albania
Rr. "Ismail Qemali" No. 32/1 Tirane 1019
Shqiperi
T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,
E: info@aca.al /W: www.aca.al

dijeni Bashkinë e Krujës, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Policinë Kufitare dhe të Migracionit dhe shërbimin e zjarrfikëseve.

Gjithashtu, Auto Club Albania do të angazhohet për zbatimin e të gjitha masave të nevojshme të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe protokolleve të sigurisë të Federatës Ndërkombëtare të Automobilizmit (FIA) për mbrojtjen ndaj Covid-19.

Duke ju falënderuar paraprakisht për kohën Tuaj, mbetemi në dispozicionin për çdo informacion të mëtejshëm.

Me konsideratat më të mira,

Eridon Lameborshi

Eridon LAMEBORSHI
Sekretar i Përgjithshëm
Auto Club Albania

[Signature]



MEMBER OF

